

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA
Franklin Academics Plus Elementary School
5737 Rising Sun Avenue, Philadelphia, PA 19120
School: 215-400-3760 • Fax: 215-400-3761

July, 2021

Të dashur prindër/familjarë të Benjamin Franklin Elementary:

Shpresojmë që kjo letër t'ju gjejë mirë dhe se ju po kaloni ca kohë duke shijuar muajt e verës.

Rajoni Shkollor i Filadelfias ndodhet në fazat e planifikimit për kthimin e sigurt fizikisht në mësim të të gjithë nxënësve. Pandemia COVID-19 ka pasur ndikim në rajonin tonë dhe në mundësitë për fëmijët tanë, në shumë mënyra, por ne jemi të përkushtuar që të bëjmë gjithçka mundemi për të rikuperuar dhe përmirësuar rezultatet e nxënësve këtë vit. Si pjesë e një strategjie më të gjerë për përmirësimin e rezultateve të të gjithë nxënësve, një ndryshim që po bëjmë është përdorimi në mënyrë graduale i një metode të standardizuar për orarin ditor të fillimit dhe mbarimit të mësimin.

Këtë vit, me mbështetje nga Shërbimet e Transportit, të gjitha oraret e autobusëve do të jenë të bashkërenditura me njëri-njëri prej tri orëve të njëjta të ziles. Standardizimi i orarit të ziles do të ndihmojë me uljen e sasisë së kohës që nxënësit kalojnë në autobusa, do të ndihmojë duke siguruar që autobusët të jenë në orar më shpesh, do të mundësojë që midis linjave të autobusit të bëhet pastrim i vazhdueshëm i pjesëve të autobusit që preken shumë dhe do të ndihmojë Zyrën e Shërbimeve të Transportit që të përballojë uljen e konsiderueshme të numrit të stafit si rezultat i dorëheqjeve dhe daljeve në pension gjatë këtyre 18 muajve të fundit.

Si rezultat, Benjamin Franklin Elementary ka orar të ri për fillimin dhe mbarimin e mësimin gjatë vitit shkollor 2021-2022. Këtë vit, shkolla do të fillojë në orën 7:30am dhe do të mbarojë në orën 2:09PM çdo ditë. Po jua japim këtë informacion tani me qëllim që të filloni të bëni paraprakisht ndonjë rregullim të nevojshëm familjar për t'u siguruar që fëmija juaj të mund ta frekuentojë shkollën në orar çdo ditë në përputhje me këtë orar të ri.

Më tepër informacion për kthimin tonë në shkollë në vjeshtë dhe mundësi që ju të merrni pjesë në mbledhje dhe ngjarje në shkollë dhe në nivel rajonal do ta ndajmë me ju gjatë fushatës së rajonit për kthimin në shkollë deri më 31 gusht – që është dita e parë e shkollës. Ndërkohë, ju inkurajoj që të vizitoni rregullisht uebsajtin e Rajonit Shkollor të Filadelfias për informacionet më të përditësuar: www.philasd.org.

Ju urojmë një verë të sigurt dhe të shëndetshme.

Sinqerisht,

R. Greene, Principal